

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 02.07.2015]

Për: Operatorin ekonomik COBIAL sh.p.k (NIPT K02715414M)

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt : **“Ndërtimi i Rrugëve në qendër të Fshatit Jorgucat”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtimi i Rrugëve në qendër të Fshatit Jorgucat”**.

Kohëzgjatja: **7 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **47.831.289 (dyzet e shtatë milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 14.05.2015.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

1. Operatori ekonomik Feba sh.p.k me vlerë 29,212,449 (njëzet e nëntë milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik Derveni 1 sh.p.k me vlerë 29,884,178 (njëzet e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke pa TVSH.
3. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Beqiri sh.p.k & Spektri sh.p.k me vlerë 31,378,050 (tridhjetë e një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik Cobial sh.p.k me vlerë 32,299,740 (tridhjetë e dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë.
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Nika sh.p.k & Kthella sh.p.k me vlerë 32,727,153 (tridhjetë e dy milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
6. Operatori ekonomik B 93 sh.p.k me vlerë 32,900,000 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH.
7. Operatori ekonomik Sireta 2F sh.p.k me vlerë 33,333,333 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik Eral Konstruksion sh.p.k me vlerë 34,150,950 (tridhjetë e katër milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Arti sh.p.k & Iliria D sh.p.k me vlerë 35,325,035 (tridhjetë e pesë milion e treqind e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
10. Operatori ekonomik Mane/S sh.p.k me vlerë 35,333,333 (tridhjetë e pesë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
11. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Bean sh.p.k & Erges Mat sh.p.k me vlerë 35,885,930 (tridhjetë e pesë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.
12. Operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k me vlerë 35,904,818 (tridhjetë e pesë milion e nëntëqind e katër mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH .
13. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Neal 86 sh.p.k & Savrikald sh.p.k & Flondi sh.p.k me vlerë 36,537,856 (tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.
14. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Shendelli sh.p.k & Filipi sh.p.k me vlerë 36,595,625 (tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH
15. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Tea-D sh.p.k & Elkri sh.p.k me vlerë 37,490,400 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.
16. Operatori ekonomik Kronos sh.p.k me vlerë 43,666,850 (dyzet e tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. Operatori ekonomik B 93 sh.p.k
2. Operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k
3. Operatori ekonomik Derveni 1 sh.p.k
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Bean sh.p.k & Erges Mat sh.p.k
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Shendelli sh.p.k & Filipi sh.p.k
6. Operatori ekonomik Feba sh.p.k
7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Beqiri sh.p.k & Spektri sh.p.k
8. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Nika sh.p.k & Kthella sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik B 93 sh.p.k

Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentat e Tenderit shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, ku është kërkuar: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” Ky operator ekonomik nuk ka shlyer detyrimet për muajin mars 2015, detyrim ky I maturuar ditën e hapjes së ofertave. Për arsye se mospërbushja i një kriteri të vetëm të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

2. Operatori ekonomik Alba Konstruksion sh.p.k

Nuk ploteson piken 2.3.4 ne DST ku shprehet se Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet.

3. Operatori ekonomik Derveni 1 sh.p.k

Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentat e Tenderit shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, ku është kërkuar: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi nuk ka shlyer detyrimet per muajin mars 2015, detyrim ky I maturuar ditën e hapjes se ofertave. Për arsye se mospërbushja i një kriteri të vetëm të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në këtë procedurë prokurimi

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Bean sh.p.k & Erges Mat sh.p.k

Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentat e Tenderit shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, ku është kërkuar: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi nuk ka shlyer detyrimet per muajin mars 2015, detyrim ky I maturuar ditën e hapjes se ofertave. Për arsye se mospërbushja i një kriteri të vetëm të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

5. Bashkimi i operatoërëve ekonomikë Shendelli sh.p.k & Filipi sh.p.k

Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentat e Tenderit shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, ku është kërkuar: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi operatori “Neal 86” shpk nuk ka shlyer detyrimet per muajin mars 2015, detyrim ky I maturuar ditën e hapjes se ofertave. Për arsye se mospërbushja i një kriteri të vetëm të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

6. Operatori ekonomik Feba sh.p.k

- a) Nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentat e Tenderit shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, ku është kërkuar: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi nuk ka shlyer detyrimet per muajin mars 2015, detyrim ky I maturuar ditën e hapjes se ofertave.
- b) Nuk ploteson asnje prej kushteve te vendosura piken 2.4 dhe 2.4.1 Kapaciteti Teknik ne DST ku shprehet se Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 23.000.000 (tetedhete e pese milion) leke pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 90.000.000 (treqind e pesedhjetë milion) leke pa tvsh.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese

7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Beqiri sh.p.k & Spektri sh.p.k

Shoqëria “Spektri” sh.p.k, nuk ka paraqitur Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Për arsye se mospërmbushja i një kriteri të vetëm të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, përbën kusht për mos kualifikimin e ofertuesve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos vazhdojë me shqyrtimin e pjesës së mbetur të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

8. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Nika sh.p.k & Kthella sh.p.k

Operatori Kthella shpk nuk ploteson kerkesen 2.4.7 ne DST ku shprehet se Operatori Ekonomik duhet te disponoje certifikaten **ISO 9001:2008** mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. dhe kerkesen 2.4.8 ku shprehet se Operatori Ekonomik duhet te disponoje certifikaten **ISO 14001:2004** mbi “Sistemet e menaxhimit te ambientit” leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik COBIAL sh.p.k (NIPT K02715414M) se oferta e paraqitur, me një vlerë 32,299,740 (tridhjetë e dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Samë Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **03.06.2015**.

Ankesa: Ka patur.

1. Operatori ekonomik “Bean” sh.p.k në datën 05.06.2015 paraqiti ankesë, duke kundërshtuar vendimin e skualifikimit nga Autoriteti Kontraktor.
Në datën 09.06.2015, Komisioni për shqyrtimin e ankesës vendosi mos pranimin e ankesës së paraqitur.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Beqiri” sh.p.k & “Spektri” sh.p.k ka paraqitur ankesë në datën 08.06.2015, duke kundërshtuar vendimin e skualifikimit nga Autoriteti Kontraktor.
Në datën 10.06.2015, Komisioni për shqyrtimin e ankesës vendosi që Komisioni i Hapjes i Vlerësimit të Ofertave të kryejë rivlerësimin e ofertës të paraqitur nga ankimuesi.
3. Operatori ekonomik “Derveni 1” sh.p.k në datën 08.06.2015 paraqiti ankesë, duke kundërshtuar vendimin e skualifikimit nga Autoriteti Kontraktor.
Në datën 11.06.2015, Komisioni për shqyrtimin e ankesës vendosi mos pranimin e ankesës së paraqitur.

